

| | |
|--|----|
| RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR | |
| PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR..... | 3 |
| PASQYRA E PERFORMANCËS | 4 |
| PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN NETO | 5 |
| PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE | 6 |
| 1 Informacion i Pergjithshem | 7 |
| 2 Bazat e pergatitjes se pasqyrave financiare | 7 |
| 3 Përmbledhje e politikave kontabël | 7 |
| 4 Mjetet monetare | 12 |
| 5 Të drejta të arkëtueshme | 12 |
| 6 Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara | 12 |
| 7 Inventarët | 12 |
| 8 Aktivët afatgjata materiale | 13 |
| 9 Llogari të pagueshme dhe të tjera | 13 |
| 10 Huamarrje afatgjata | 14 |
| 11 Kapitali i nënshkruar | 14 |
| 12 Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit | 14 |
| 13 Shpenzime të personelit | 14 |
| 14 Shpenzime të tjera | 15 |
| 15 Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesi | 15 |
| 16 Shpenzimi i tatimit mbi fitimin | 15 |
| 17 Transaksionet me palët e lidhura..... | 15 |
| 18 Angazhime dhe ngjarje të kushtëzuara | 16 |
| 19 Ngjarje pas dates se bilancit..... | 16 |

RAPORTI I AUDITUESVE TE PAVARUR

Për Ortakun e Vetëm dhe Administratorin e shoqërisë LIBEREST GRUP SHPK

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë tregtare LIBEREST GRUP SHPK, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2019, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto dhe pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, për pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 Dhjetor 2019 dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombetare të Kontabilitetit të përmirësuar (SKK).

Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Administratoreve dhe të Personave të Ngarkuar me Mbikqyrjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare që japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë në përputhje me Standardet Kombetare të Kontabilitetit, dhe për të tilla kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me drejtimin janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare


Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arësyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.


Sokol Toska
Auditues Ligjor



Rr. Tish Dahia, Kompleksi Kika 2
Kulla 2, Nr. 33
Tirana 1060, Albania
+355 683317751
contact@toska.al
L62207031A

16 Mars 2020

LIBEREST GRUP SH.P.K.
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
 më 31 Dhjetor 2019
 (të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë)


| | <u>Shënime</u> | <u>31 Dhjetor 2019</u> | <u>31 Dhjetor 2018</u> |
|--|----------------|------------------------|------------------------|
| Aktivet | | | |
| Aktivet afatshkurtra | | | |
| Mjete monetare | 4 | 5,414,406 | 786,783 |
| Të drejta të arkëtueshme | 5 | 9,044,452 | 10,504,899 |
| Shpenzime të shtyra | | - | 862,529 |
| Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara | 6 | 1,301,923 | - |
| Inventarët | 7 | 1,649,550 | 1,649,550 |
| Total i aktiveve afatshkurtra | | 17,410,331 | 13,803,761 |
| Aktivet afatgjata | | | |
| Aktive afatgjata materiale | 8 | 52,047,811 | 40,943,769 |
| Totali i aktiveve afatgjata | | 52,047,811 | 40,943,769 |
| Totali i aktiveve | | 69,458,141 | 54,747,530 |
| Detyrimet dhe kapitali | | | |
| Detyrimet afatshkurtra | | | |
| Llogari të pagueshme dhe të tjera | 9 | 1,195,512 | 4,861,586 |
| Totali i detyrimeve afatshkurtra | | 1,195,512 | 4,861,586 |
| Detyrimet afatgjata | | | |
| Huamarrje afatgjata | 10 | 59,460,430 | 41,194,930 |
| Totali i detyrimeve afatgjata | | 59,460,430 | 41,194,930 |
| Totali i detyrimeve | | 60,655,942 | 46,056,516 |
| Kapitali | | | |
| Kapitali i nënshkruar | 11 | 1,000,000 | 1,000,000 |
| Fitimi/(humbja) e pashpërndare | | 7,691,014 | 7,639,589 |
| Fitimi/(humbja) e vitit | 16 | 111,186 | 51,425 |
| Totali i kapitalit | | 8,802,200 | 8,691,014 |
| Totali i detyrimeve dhe kapitalit | | 69,458,141 | 54,747,530 |

Bilanci Kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7-16, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Drejtimi në datën 11 Mars 2020 dhe janë nënshkruar nga:

LIBEREST GRUP
 Administratori

MB CONSULTING SHPK
 Përgatiti



LIBEREST GRUP SH.P.K.

PASQYRA E PERFORMANCËS

për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë)

| | <u>Shënime</u> | <u>Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2019</u> | <u>Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2018</u> |
|--|----------------|--|--|
| Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit | 12 | 22,144,300 | 12,175,553 |
| Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar | | 1,428,067 | - |
| Të ardhura të tjera të shfrytëzimit | | - | 20,723 |
| Totali i të ardhurave | | 23,572,367 | 12,196,276 |
| Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme | | (1,062,740) | (1,836,297) |
| Shpenzime të personelit | 13 | (17,710,165) | (7,118,760) |
| Shpenzime konsumi dhe amortizimi | 8 | (2,176,496) | (2,099,954) |
| Shpenzime të tjera shfrytëzimi | 14 | (1,231,884) | (771,076) |
| Totali i shpenzimeve | | (22,181,285) | (11,826,085) |
| Fitimi (Humbja) nga aktiviteti i shfrytëzimit | | 1,391,083 | 370,190 |
| Të ardhura/(shpenzime) nga interesi | 15 | (1,060,165) | (349,875) |
| Fitimi/(humbja) nga kurset e këmbimit | | (93,840) | 44,317 |
| Të ardhura dhe shpenzimeve financiare neto | | (1,154,005) | (305,558) |
| Fitimi (Humbja) para tatimit | | 237,078 | 64,633 |
| Shpenzimi i tatimit mbi fitimin | 16 | (125,892) | (13,208) |
| Fitimi/(humbja) e periudhës | | 111,186 | 51,425 |
| Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse për vitin | | - | - |
| Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin | | 111,186 | 51,425 |

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7-16, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.



LIBEREST GRUP SH.P.K.**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN NETO**

për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë)

| | <u>Kapitali i nënshkruar</u> | <u>Fitimet e pashpërdara</u> | <u>Totali</u> |
|-----------------------------------|----------------------------------|----------------------------------|------------------|
| Gjendja më 1 janar 2018 | 1,000,000 | 7,639,589 | 8,639,589 |
| Fitimi (humbja) e vitit | - | 51,425 | 51,425 |
| Gjendja më 31 Dhjetor 2018 | 1,000,000 | 7,691,014 | 8,691,014 |
| Fitimi (humbja) e vitit | - | 111,186 | 111,186 |
| Gjendja më 31 Dhjetor 2019 | 1,000,000 | 7,802,200 | 8,802,200 |

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7-16, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

LIBEREST GRUP SH.P.K.**PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE**

për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë)

| | | Viti i mbyllur me | Viti i mbyllur me |
|--|----------------|--------------------------|--------------------------|
| | Shënime | 31 Dhjetor 2019 | 31 Dhjetor 2018 |
| Fluksi i mjeteve monetare nga aktiviteti i shfrytëzimit | | | |
| Fitimi/(humbja) e periudhës | | 111,185 | 51,425 |
| Rregullime për: | | | |
| Shpenzime financiare jo-monetare | | 1,060,165 | - |
| Shpenzime për tatimin mbi fitimin jo-monetare | | 10,014 | (509,370) |
| Shpenzime konsumi dhe amortizimi | 8 | 2,176,496 | 2,099,954 |
| Fitim/(humbje) nga shitja e aktiveve afatgjata materiale | | 3,171 | - |
| Ndryshimet në kapitalin punues: | | | |
| Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera | 5,6 | 1,021,053 | (3,110,767) |
| Rritje/(rënie) detyrimet e pagueshme dhe të tjera | 9 | (4,736,253) | (37,868,522) |
| Mjete monetare neto nga aktiviteti i shfrytëzimit | | (354,168) | (39,337,281) |
| Fluksi i mjeteve monetare nga aktiviteti i investimit | | | |
| Blerje e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale | 8 | (13,283,709) | (4,299,675) |
| Mjete monetare neto nga aktiviteti i investimit | | (13,283,709) | (4,299,765) |
| Fluksi i mjeteve monetare nga aktiviteti i financimit | | | |
| Hyrje nga huat | 10 | 18,265,500 | 41,316,338 |
| Mjete monetare neto nga aktiviteti i financimit | | 18,265,500 | 41,316,338 |
| Rritje/(rënie) neto në mjete monetare | | 4,627,623 | (2,320,617) |
| Mjete monetare në fillim të periudhës | 4 | 786,783 | 3,107,400 |
| Mjetet monetare në fund të periudhës | 4 | 5,414,406 | 786,783 |

Pasqyra e flukseve të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7-16, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

LIBEREST GRUP SH.P.K.

SHËNIME SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2019 (të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

1 INFORMACION I PERGJITHSHEM

Shoqëria LIBEREST GRUP SH.P.K ("Shoqëria") është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më 06/02/2014 me numër identifikimi NUIS L47606601G.

Selia e regjistruar e Shoqërisë është në adresën Qender Librazhd TogeZ Ish depot e Rezervave te Shtetit, TogeZ, Librazhd, Elbasan.

Aktiviteti kryesor i shoqërisë është Import-Eksport, tregtimin e artikujve te ndryshem te te gjitha llojeve, me shumice dhe pakice. Stilim,projektim, konfeksionim tekstiles per perdorim civil dhe industrial si dhe veshjeve mbrojtese per perdorime speciale ne sektorin e mbrojtjes, policise, zjarrfikesve etj. Prodhimin e aksesoreve tekstile dhe metalike ne funksion te prodhimit. Projektim dhe montime te sistemeve hidraulike, elektrike, elektronike, kondicionimit, aspirimit. Tregtim i konfeksione te llojeve te ndryshme.

2 BAZAT E PERGATITJES SE PASQYRAVE FINANCIARE

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat Financiare janë përgatitur ne përputhje me Standardet Kombëtare te Kontabilitetit (SKK).

Bazuar ne SKK 11 "Tatimi mbi Fitimin", paragrafi 4, Shoqëria ka zgjedhur të mos kontabilizojë tatimet e shtyra në pasqyrat financiare.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat Financiare janë përgatitur duke u bazuar ne koston historike, përveç rasteve nëse specifikohet ndryshe.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Pasqyrat financiare janë pasqyruar në Lekë e cila është monedha funksionale e Shoqërisë. Shifrat janë te rumbullakosura në Lekë.

2.4 Përdorimi i gjykimeve dhe vlerësimeve

Paraqitja e Pasqyrave Financiare në përputhje me SKK, kërkon qe menaxhimi të bëjë vlerësime, gjykime e supozime që ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe vlerën e raportuar të aktiveve, detyrimeve, te ardhurave e shpenzimeve. Vlerësimet dhe supozimet bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë të ndryshëm në varësi të rrethanave. Rezultatet aktuale mund te ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen vazhdimisht. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën kur ndodh rishikimi si dhe ne çdo periudhe te ardhme që preket.

Në veçanti, informacionet mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare.

2.5 Periudhat krahasuese

Të dhënat e periudhave të mëparshme mund të ri klasifikohen për t'i bërë ato të krahasueshme me paraqitjen e të dhënave të periudhës ushtrimore.

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL

Politikat kontabël ne vijim janë aplikuar ne mënyre te qëndrueshme ne te gjitha periudhat e paraqitura ne pasqyrat financiare, me përjashtim te rasteve kur specifikohet ndryshe nëse ka te tilla.

LIBEREST GRUP SH.P.K.

SHËNIME SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2019

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

3.1 Transaksionet ne monedha te huaja

Transaksionet ne monedhe te huaj regjistrohen ne monedhën funksionale me kursin e këmbimit ne datën e transaksionit. Mjetet monetare ne monedhe te huaj rivlerësohen ne fund te çdo periudhe raportuese me kursin zyrtar te këmbimit ne datën e raportimit.

Mjetet jo-monetare ne monedhe te huaj regjistrohen ne monedhën funksionale me kursin e këmbimit te datës se kryerjes se transaksionit, ndërsa mjetet jo-monetare qe maten me vlere te drejte rivlerësohen ne monedhën funksionale me kursin e këmbimit ne datën kur përcaktohet vlere e drejte.

Fitimi ose humbja qe rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë ne pasqyrën e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit te përdorura për konvertim ne 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 janë si me poshtë:

| | 31 Dhjetor 2019 LEK | 31 Dhjetor 2018 LEK |
|------|------------------------|------------------------|
| EURO | 121.77 | 123.42 |

3.2 Instrumentet financiare

Instrumentet financiare jo-derivative përbehen nga llogari te arkëtueshme, mjete monetare, hua te marra dhe te dhëna dhe llogari te pagueshme. Instrumentet financiare jo-derivative njihen fillimisht me vlerën e drejte plus çdo kosto transaksioni qe lidhet me to, përveç siç përshkruhet me poshtë. Për instrumentet e mbajtur me vlere te drejte nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë ne pasqyrën e te ardhurave dhe shpenzimeve. Ne vijim te njohjes fillestare instrumentet financiare jo-derivative maten siç përshkruhet me poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit.

Aktivitet financiare çregjistrohen kur skadojnë te drejtat kontraktuale te shoqërisë mbi flukset e parasë se aktivitet financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një pale e trete pa mbajtur kontrollin ose gjithë rreziqet dhe përfitimet thelbësore te aktivitet. Blerjet dhe shitjet normale te aktiveve financiare kontabilizohen ne datën e transaksionit, qe është data ne te cilën shoqëria angazhohet te blejë apo te shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale te shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare dhe te tjera ekuivalente

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogarite rrjedhëse, si dhe depozitat afatshkurtra me një maturitet deri ne tre muaj.

Llogarite e arkëtueshme

Llogarite e arkëtueshme dhe llogarite e tjera te arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejte dhe me pas me kosto te amortizuar duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve te arkëtueshme llogaritet kur ka te dhëna se shoqëria nuk do te jete ne gjendje te mbledhë te gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare te debitorit, mundësia qe debitori te falimentoje ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues qe llogarite e arkëtueshme te zhvlerësohen.

Shuma e provizionit llogaritet si diference midis vlerës se mbetur dhe vlerës aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parasë te skontuara me normën efektive te interesit.

Llogarite e pagueshme

Llogarite e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre te drejte dhe ne vijim maten me kosto te amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Huamarrjet dhe parapagimet

Huat e marra nga Institucionet Financiare njihen fillimisht me vlerën e drejte, duke zbritur koston e transaksionit. Detyrimet financiare maten me pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke njohur shpenzimin e interesit mbi bazën e interesit efektiv.

LIBEREST GRUP SH.P.K.

SHËNIME SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2019 (të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

Metoda e normës efektive të interesit është një metode për llogaritjen e kostos së amortizuar të një detyrimi financiar dhe për alokimin e shpenzimeve të interesit përgjatë periudhës. Norma efektive e interesit është norma e cila skanton saktësisht pagesat e ardhshme të vlerësuar përgjatë jetës së pritshme të detyrimit financiar, ose, ku është e përshtatshme, për një periudhe më të shkurtër.

Te tjera

Instrumente të tjera financiare jo derivative janë matur me koston e amortizueseje, duke përdorur metodën e normës së interesit efektiv, duke zbritur humbjet nga zhvlerësimet.

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme janë klasifikuar si kapital.

3.3 Aktivët afatgjatë materiale

i. Njohja dhe matja

Aktivët afatgjatë materiale maten me kosto, duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostoja përfshin shpenzimet të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vete shoqëria përfshin koston e materialeve dhe punës direktet dhe çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato regjistrohen si zëra të ndryshëm të ndara nga njëra tjetra.

Fitimet ose humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit të aktiveve afatgjatë materiale përcaktohen duke krahasuar të ardhurën nga shitja me vlerën kontabël neto të aktivitetit afatgjatë material mbetur dhe njihen në të ardhura ose humbje të tjera.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjatë materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën lineare apo zbritëse të amortizimit, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjesë të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivët e marra me qira financiare amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Toka dhe aktivët në proces nuk amortizohen. Metodatat dhe normat e amortizimit për periudhën aktuale dhe të mëparshme janë si më poshtë:

| | | |
|---------------------------|-----|-----------------------|
| Ndërtesa | 5% | (mbi vlerën e mbetur) |
| Makineri dhe pajisje | 20% | (mbi vlerën e mbetur) |
| Mjete transporti | 20% | (mbi vlerën e mbetur) |
| Pajisje kompjuterike | 25% | (mbi vlerën e mbetur) |
| Pajisje zyre dhe të tjera | 20% | (mbi vlerën e mbetur) |

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

LIBEREST GRUP SH.P.K.

SHËNIME SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2019

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

3.4 Inventarët

Inventarët maten fillimisht me kosto. Kostoja e inventarit përfshin, përveç çmimit të blerjes, edhe të gjitha kostot e tjera që nevojiten për të sjellë inventarin në gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese.

Pas njohjes fillestare inventarët vlerësohen me vlerën më të vogël ndërmjet koston dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja e inventarit përcaktohet sipas metodës së mesatares së ponderuar. Vlera neto e realizueshme është çmimi i shitjes i vlerësuar në rrjedhën normale të biznesit, minus kostot e vlerësuara të nevojshme për të kryer shitjen. sipas metodës së koston mesatare të ponderuar.

3.5 Zhvlerësimi

i. Aktivet financiare

Një aktiv financiar që nuk mbahet me vlerën e drejtë, vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë të dhënë që ka pësuar rënie në vlerë. Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi dhe të cilat mund të maten me besueshmëri.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të aktualizuara me normën efektive të interesit. Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale, ndërsa aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Aktivet jo financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo financiare të shoqërisë rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë të dhënë që ka pësuar rënie në vlerë. Nëse ka të dhëna të tilla, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Vlera e rikuperueshme është vlera më e madhe midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.6 Përfitimet e punonjësve

Gjatë ecurisë normale të aktivitetit të saj, shoqëria paguan kontributet shoqërore dhe shëndetësore në emër të vet dhe të punonjësve të saj, të cilat janë të detyrueshme sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi. Këto kosto të kryera në emër të shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin e ndodhjes.

3.7 Provizionet

Një provizion njihet kur, si pasojë e ngjarjeve të kaluara, shoqëria ka detyrime aktuale ligjore apo konstruktive të cilat mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme, dhe është e mundur që të nevojiten flukse dalëse të burimeve ekonomike për të shlyer këto detyrime. Provizionet përcaktohen nga aktualizimi i flukseve të pritshme me një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të parasë dhe rrezikut specifik të detyrimeve.

3.8 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që shoqëria do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, për shlyerje të menjëhershme etj.

Te ardhurat dhe shpenzimet njihen në pasqyrat financiare të periudhës të cilës i përkasin. Në lidhje me shitjen e mallrave, të ardhurat njihen kur ndryshimi i pronësisë së bashku me rrezikun që vjen nga ky ndryshim, janë transferuar tek blerësi. Te ardhurat nga shërbimet njihen kur shërbimi është kryer, në varësi

LIBEREST GRUP SH.P.K.

SHËNIME SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2019

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

te fazës së përfundimit të transaksionit në datën e raportimit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3.9 Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat financiare përfshijnë te ardhurat nga interesat për llogarite bankare, dhe përfitimet nga diferencat e këmbimit. Interesat njihen ashtu siç përlogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet për interesa dhe humbjet nga luhatjet e kurseve të këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejte të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejte nëpërmjet pasqyrës së te ardhurave dhe shpenzimeve, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare.

Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e te ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv. Fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit raportohen në baza neto.

3.10 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e te ardhurave dhe shpenzimeve. Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi te ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara në periudhën e raportimit.

3.11 Ngjarjet pas datës së bilancit

Ngjarjet pas datës së raportimit, të cilat ofrojnë dëshmi për kushtet që ekzistojnë në datën e raportimit, trajtohen si ngjarje të korrigjueshme në këto pasqyra financiare. Ata që janë tregues të kushteve që lindin pas datës së raportimit janë trajtuar si ngjarje të pakorrigjueshme.

LIBEREST GRUP SH.P.K.
SHËNIME SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2019
 (të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

4 MJETET MONETARE

Gjendja e mjeteve monetare në arke dhe bankë në fund të vitit ushtrimor paraqitet si më poshtë:

| | <u>31 Dhjetor 2019</u> | <u>31 Dhjetor 2018</u> |
|--------------------------------|-------------------------|------------------------|
| Mjete monetare në bankë | 5,407,716 | 779,772 |
| - në Lekë | 1,219,067 | 376,753 |
| - në monedhë të huaj | 4,188,649 | 403,019 |
| Mjete monetare në arkë | 6,690 | 7,011 |
| - në Lekë | 6,690 | 7,011 |
| - në monedhë të huaj | - | - |
| Totali | <u>5,414,406</u> | <u>786,783</u> |

5 TË DREJTA TË ARKËTUESHME

Llogarite e arkëtueshme me 31.12.2018 dhe 31.12.2019 përbehen si me poshtë:

| | <u>31 Dhjetor 2019</u> | <u>31 Dhjetor 2018</u> |
|--|-------------------------|--------------------------|
| Llogari të arkëtueshme | 401,832 | 401,833 |
| Llogari të arkëtueshme nga palë të lidhura | 138,152 | 3,727,417 |
| Tatimi mbi vlerën e shtuar | 2,643,512 | 471,959 |
| Tatim fitimi | 406,941 | 420,991 |
| Debitorë të tjerë | 454,015 | 454,015 |
| Garanci të dhëna | 5,000,000 | 5,000,000 |
| Të tjera | - | 28,685 |
| Totali | <u>9,044,452</u> | <u>10,504,899</u> |

6 TË ARKËTUESHME NGA TË ARDHURAT E KONSTATUARA

Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara përbehet nga vlera e punimeve të realizuara gjatë periudhës dhe do të dorëzohen në periudhën pasardhëse si vijon:

| | <u>31 Dhjetor 2019</u> | <u>31 Dhjetor 2018</u> |
|---------------------------|-------------------------|------------------------|
| Të ardhura të llogaritura | 1,301,923 | - |
| Totali | <u>1,301,923</u> | <u>-</u> |

7 INVENTARËT

Inventarët në pasqyrën e pozicionit financiar paraqiten si me poshtë:

| | <u>31 Dhjetor 2019</u> | <u>31 Dhjetor 2018</u> |
|-------------------------------------|-------------------------|-------------------------|
| Lëndë e parë dhe materiale të tjera | 325,499 | 325,499 |
| Inventar i imët | 1,701,322 | 1,701,322 |
| Totali | <u>2,026,821</u> | <u>2,026,821</u> |

LIBEREST GRUP SH.P.K.
SHËNIME SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2019
(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

8 AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

| | Ndërtime & përmirësime ne proces | Ndërtime & përmirësime Makineri dhe pajisje | Mjete transporti | Mobilje & Pajisje Zyre | Pajisje TIK | Totali | |
|------------------------------|----------------------------------|---|------------------|------------------------|------------------|--------------|-------------------|
| Kosto | | | | | | | |
| Gjendje me 31.01.2018 | 39,674,540 | - | 86,146 | 376,870 | 1,253,980 | 7,516 | 41,022,182 |
| Shtesa | 4,278,952 | - | - | - | - | - | 4,278,952 |
| Pakësime | - | - | - | (376,870) | - | - | - |
| Gjendje me 31.12.2018 | 43,953,492 | - | 86,146 | - | 1,253,980 | 7,516 | 45,301,134 |
| Shtesa | - | 13,258,809 | 24,900 | - | - | - | 13,283,708 |
| Pakësime | - | - | - | - | - | (7,516) | (7,516) |
| Gjendje me 31.12.2019 | 43,953,492 | 13,258,809 | 111,046 | - | 1,253,980 | - | 58,577,326 |
| Amortizimi | | | | | | | |
| Gjendje me 01.01.2018 | 1,982,467 | - | 17,229 | - | 255,836 | 1,879 | 2,257,411 |
| Amortizimi i vitit | 1,885,132 | - | 13,783 | - | 199,628 | 1,409 | 2,099,952 |
| Pakësime | - | - | - | - | - | - | - |
| Gjendje me 31.12.2018 | 3,867,599 | - | 31,012 | - | 455,464 | 3,288 | 4,357,363 |
| Amortizimi i vitit | 2,004,295 | - | 11,442 | - | 159,704 | 1,056 | 2,176,496 |
| Pakësime | - | - | - | - | - | (4,344) | (4,344) |
| Gjendje me 31.12.2019 | 5,871,894 | - | 42,454 | - | 615,168 | - | 6,529,515 |
| Vlera e mbetur neto | | | | | | | |
| Gjendja me 31.12.2018 | 40,085,893 | - | 55,134 | - | 798,516 | 4,226 | 40,943,769 |
| Gjendja me 31.12.2019 | 38,081,598 | 13,258,809 | 68,592 | - | 638,812 | - | 52,047,811 |

9 LLOGARI TË PAGUESHME DHE TË TJERA

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera paraqiten si më poshtë:

| | <u>31 Dhjetor 2019</u> | <u>31 Dhjetor 2018</u> |
|---|------------------------|------------------------|
| Llogari të pagueshme | 731,886 | 181,096 |
| Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura | - | 4,470,517 |
| Sigurime shoqërore dhe shëndetësore | 463,626 | 209,973 |
| Totali | 1,195,512 | 4,861,586 |

LIBEREST GRUP SH.P.K.
SHËNIME SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2019
 (të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

10 HUAMARRJE AFATGJATA

Huat afatgjata paraqiten më poshtë:

| | <u>31 Dhjetor 2019</u> | <u>31 Dhjetor 2018</u> |
|-------------------------|------------------------|------------------------|
| Hua nga palë të lidhura | 59,460,430 | 41,194,930 |
| Totali | 59,460,430 | 41,194,930 |

11 KAPITALI I NËNSHKRUAR

Kapitali i nënshkruar i Shoqërisë është 1,000,000 Lekë. Kapitali zotërohet tërësisht nga Ortaku i Vetëm, shoqëria Grassi Albania SHPK:

| | <u>Viti 2019</u> | | <u>Viti 2018</u> | |
|----------------|------------------|-------------|------------------|-------------|
| Grassi Albania | 1,000,000 | 100% | 1,000,000 | 100% |
| Totali | 1,000,000 | 100% | 1,000,000 | 100% |

12 TË ARDHURA NGA AKTIVITETI I SHFRYTËZIMIT

Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit paraqiten më poshtë:

| | <u>Viti i mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2019</u> | <u>Viti i mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2018</u> |
|--------------------------|--|--|
| Te ardhura nga shërbimet | 22,144,300 | 12,175,553 |
| Totali | 22,144,300 | 12,175,553 |

13 SHPENZIME TË PERSONELIT

Shpenzime të personelit përbëhet nga pagat bruto të punonjësve dhe kostot e sigurimeve shoqërore që paguan shoqëria. Numri mesatar i punonjësve gjatë vitit ka qene 47 punonjës (2018: 20).

| | <u>Viti i mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2019</u> | <u>Viti i mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2018</u> |
|--------------------------|--|--|
| Shpenzime për paga | 15,105,226 | 6,106,103 |
| Kontributet e sigurimeve | 2,604,939 | 1,012,657 |
| Totali | 17,710,165 | 7,118,760 |

LIBEREST GRUP SH.P.K.
SHËNIME SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2019
 (të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

14 SHPENZIME TE TJERA

Shpenzimet e tjera përbëhen si më poshtë:

| | <u>Viti i mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2019</u> | <u>Viti i mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2018</u> |
|---------------------------------|--|--|
| Shpenzime Qiraje | 158,700 | 134,895 |
| Shpenzime konsulence | 267,721 | 583,366 |
| Shpenzime të tjera | 405,261 | 33,285 |
| Shpenzime për shërbimet bankare | 16,202 | 19,529 |
| Shpenzime taksa lokale | 384,000 | - |
| Totali | <u>1,231,884</u> | <u>771,076</u> |

15 TE ARDHURAT DHE SHPENZIMET NGA INTERESI

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi paraqiten më poshtë:

| | <u>Viti i mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2019</u> | <u>Viti i mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2018</u> |
|---|--|--|
| Shpenzime interesi, hua nga palë të lidhura | 1,060,165 | 349,875 |
| Totali | <u>1,060,165</u> | <u>349,875</u> |

16 SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN

Bazuar në legjislacionin Shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin është 15% për vitin 2019 (2018: 15%).

Deklaratat tatimore të tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara konsiderohen vetë-deklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë regjistrimet dhe deklaratat e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final.

Legjislacioni tatimor dhe ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

| | <u>31 Dhjetor 2019</u> | <u>31 Dhjetor 2018</u> |
|---|------------------------|------------------------|
| Fitimi (humbja) para tatimit | 237,078 | 64,633 |
| Shpenzime te panjohura | 602,204 | 23,420 |
| Fitimi (humbja) e tatueshme e vitit | <u>839,282</u> | <u>88,053</u> |
| Përqindja e tatimit mbi fitimit | 15% | 15% |
| Tatimi mbi fitimin | <u>125,892</u> | <u>13,208</u> |
| Fitimi (humbja) neto e vitit financiar | <u>111,186</u> | <u>51,425</u> |

17 TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA

Një numër transaksionesh mund të kryhen me palët e lidhura në rrjedhën normale të biznesit. Këto transaksione janë kryer në terma tregtare dhe në normat e tregut.

Gjendjet dhe transaksionet me palët e lidhura paraqiten si më poshtë:

LIBEREST GRUP SH.P.K.**SHËNIME SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2019**

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)


| | <u>31 Dhjetor 2019</u> | <u>31 Dhjetor 2018</u> |
|---|------------------------|------------------------|
| Aktivët afatshkurtra | | |
| Llogari të arkëtueshme - mëma | 138,152 | 3,727,417 |
| Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara - mëma | 1,301,923 | - |
| Total Aktivët afatshkurtra | 2,440,075 | 3,727,417 |
| Llogari të pagueshme dhe të tjera | | |
| Llogari të pagueshme - mëma | - | 4,470,517 |
| Total llogari të pagueshme dhe të tjera | - | 4,470,617 |
| Huamarrje afatgjata | | |
| Njësia mëmë | 59,460,430 | 41,194,930 |
| Total Huamarrje afatgjata | 59,460,430 | 41,194,930 |
| Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit | | |
| Njësia mëmë | 22,144,300 | 12,175,553 |
| Total të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit | 22,144,300 | 12,175,553 |
| Blerje | | |
| Njësia mëmë | - | (4,120,642) |
| Total blerje | - | (4,120,642) |
| Shpenzime interesi | | |
| Njësia mëmë | (1,060,165) | (349,875) |
| Total shpenzime interesi | (1,060,165) | (349,875) |

18 ANGAZHIME DHE NGJARJE TË KUSHTËZUARA

Shoqëria nuk është subjekt i ndonjë çështje ligjore të ndërmarrë nga palë të treta kundër saj më 31 dhjetor 2019 që mund të sjellë humbje apo flukse të rëndësishme dalëse në të ardhmen.

19 NGJARJE PAS DATES SE BILANCIT

Ngjarje të ndodhura pas datës së bilancit për të cilat bëhen rregullime apo ngjarje të ndodhura pas date së bilancit për të cilat nuk bëhen rregullime nuk ka.



LIBEREST GRUP SHPK.

LIBRAZH, TOGEZ

KOMUNA QENDER

ISH DEPOT E REZERVAVE

NIPT L47606601G

Librazhd, me 20/01/2020

VENDIM I ASAMBLESE SE ORTAKUT TE VETEM NR. 01/2020

Asambleja e pergjithshme e mbledhur me date 20.01.2019, ne seline ligjore te shoqërise "Liberest Grup" shpk me seli ne Ish Depot e Rezervave te Shtetit, TogeZ, Komuna Qender, Librazhd, shoqeri regjistruar me numer NUIS L47606601G, me ortak te vetem Shoqeria "GRASSI ALBANIA" shpk, perfaqesuar nga administratori Znj. Sonila Koçi, vendos te emeroje ekspert kontabel te rregjistrua (te autorizuar) në mbështetje të nenit 41, te Ligjit NR 10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", për auditimin e pasqyrave financiare te vitit 2019, zotin Andrea Toska Sokol, me licensë nr. 149, lëshuar me date 31.03.2006, nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar dhe regjistruar në organet fiskale, me NIPT L62207031A

per Ortakun e vetem

Grassi Albania shpk



LIBEREST GRUP SHPK
Selia Ish Depot e Rezervave te Shtetit – TogeZ Qender, Librazhd – NIPT L47606601G

Alfredo Grassi spa

VERBALE DEL CONSIGLIO DI AMMINISTRAZIONE DEL 20 GENNAIO 2020

L'anno 2020, il giorno 20 del mese di gennaio, alle ore 9,00 presso la sede legale della società Alfredo Grassi S.p.a. si è riunito il Consiglio di Amministrazione della stessa per discutere e deliberare sul seguente

Ordine del giorno:

1. Nomina di un Revisore Contabile per la revisione e certificazione del Bilancio d'esercizio al 31.12.2019 della società controllata Grassi Albania Shpk
2. Conferire poteri all'amministratore di Grassi Albania Shpk di nominare un Revisore Contabile per la revisione e certificazione del Bilancio d'esercizio al 31.12.2019 della società controllata Liberest Grup

Assume la presidenza il Presidente del Consiglio Roberto Grassi, il quale accerta l'identità e la legittimazione dei presenti e constata che l'odierna riunione:

- è stata validamente convocata mediante avviso di convocazione consegnato e sottoscritto tempestivamente da tutti gli aventi diritto, e che essa è validamente costituita e può validamente deliberare, essendo totalitaria, grazie alla presenza:
- di tutti e due i Consiglieri, in persona di esso Presidente e del vicepresidente Alfredo Grassi, nonché dei membri effettivi del Collegio Sindacale.

Su indicazione del Presidente, il Consiglio chiama a fungere da segretario il sig. Alfredo Grassi.

Iniziando la trattazione dell'argomento posto all'ordine del giorno, il Presidente precisa che è necessario procedere alla nomina di un Revisore Contabile affinché proceda alla revisione e certificazione del bilancio d'esercizio in chiusura al 31/12/2019 della società controllata Grassi Albania shpk; su indicazione di Sonila Koci, amministratrice di Grassi Albania si sono valutate le credenziali del sig. SOKOL ANDREA TOSKA, iscritto all'ordine dei revisori albanesi al n.149, in data 31/03/2006, P.Iva L62207031A, a seguire il Presidente informa circa la necessità di conferire i poteri a Sonila Koci, amministratrice di Grassi Albania Shpk per nominare un revisore contabile per la revisione e certificazione del bilancio d'esercizio in chiusura al 31/12/2019 della società Liberest Grup Shpk.

Dopo breve discussione sull'argomento, il Consiglio, all'unanimità dei voti,


delibera di

- nominare il sig. SOKOL ANDREA TOSKA, nato a Fier, Albania, in data 06/06/1977 Carta di Identità nr.024966917, emessa in data 16/04/2009 ed iscritto all'ordine dei revisori albanesi n.149, in data 31/03/2006, P.Iva L62207031A, in qualità di Revisore Contabile, il quale dovrà procedere alla revisione e certificazione del Bilancio d'esercizio al 31/12/2019 della società controllata Grassi Albania shpk.
- autorizzare la sig.ra Sonila Koci, amministratrice di Grassi Albania shpk, ad effettuare ogni attività necessaria per rendere effettiva la nomina del revisore contabile sig. Sokol Andrea Toska.
- conferire poteri a Sonila Koci, amministratrice di Grassi Albania Shpk, di nominare un Revisore Contabile per la revisione e certificazione del Bilancio d'esercizio al 31.12.2019 della società controllata Liberest Grup Shpk

Null'altro essendovi a deliberare, alle ore 9.25, il Presidente scioglie la seduta, demandando al segretario di provvedere alla stesura del relativo verbale.

IL PRESIDENTE

sig. Roberto Grassi

A handwritten signature in dark ink, appearing to be 'Roberto Grassi', written in a cursive style with a large loop at the end.

IL SEGRETARIO

sig. Alfredo Grassi

A handwritten signature in dark ink, appearing to be 'Alfredo Grassi', written in a cursive style with a small flourish at the end.